

## Sa koncentrat i nevojiten një lope?

**Koncentrat: Plotësimi i nevojave me koncentrat në çdo fazë të laktacionit është një nga kushtet bazë të ushqyerjes.**

Furnizimi i gabuar me koncentrat në fazën e tranzitit mund të çojë në ketozë, acidozë, mungesë vitaminash dhe në shumë probleme të tjera pasuese. Pak para dhe pas pjelljes rumeni nuk duhet të ngarkohet. Kështu menjëherë pas pjelljes duhet të ushqehet me koncentrat, që të plotësohet sa më mirë kërkesa për lëndë ushqyese pas pjelljes.

### **Periudha e tharjes ndahet në 2 faza:**

Në pesë javët e para duhet të parandalohet dhjamosja.

Në 3 javët në vazhdim lopa duhet të mësohet me racionin që përdoret për lopët me rendiment të lartë. Për shkak të zvogëlimit të vëllimit të rumenit lopa nuk dhjamoset më me racionet e theksuara koncentratesh.

### **Udhëzimet:**

Të paktën 14 ditë, më mirë akoma, 20 ditë përpara datës së llogaritur për pjellje të fillohet me koncentrat, rritje e ngadaltë me një maksimum prej një të tretën e kilogramit (300 gr) në ditë.

7-10 ditë përpara pjelljes lopa duhet të marrë 2 - 2,5 kg koncentrat. Mënyra e dhënies së koncentratit: koncentrat i balancuar, si grupi i lopëve me rendiment të lartë.

Por kini kujdes! Burime kalciumi si tulli i panxharit, bliri dhe përzierjet minerale duhen shmangur për shkak të rrezikut të vetë përmbajtjes së lartë të kalciumit që përmban qumështi.

**Pas pjelljes** lopa duhet nxitur që të ushqehet me foragjere. Kjo arrihet nëpërmjet ushqyerjes me sasi të vogla koncentratesh të përfshira në ushqimin bazë. Sasia e koncentratit nuk duhet rritur në ditët e para. Vetëm pas ditës së tretë pas pjelljes fillohet të rritet sasia e koncentratit. Udhëzimet për rritjen e përmbajtjes së koncentratit vlejné si më lartë:

Një rritje maksimale prej një të tretën e kilogramit (300 gr) në ditë, korrespondon me 2 kilogram për javë.

**Këshillë:** Gjatë ushqyerjes, ushqimi bazë duhet mbajtur nën vëzhgim nëpërmjet rumenit (gropa e urisë majtas) dhe zorrës (djathtas).

